



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA FUSHE -ARREZ

KESHILLI

Nr. 2798 Prot.

Fushe Arrez me, 06.09, 2024

VENDIM

NR.45 DATE 28.08.2024

PER

**"PER NGRITJE KOMISIONI PER ZGJIDHJE KONFLIKTI PER RENDIN E UJIT VADITES NE LAGJEN GOJAN,
FSHATI KRYEZI, NJESIA ADMINISTRATIVE QAFE-MALI"**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen Vendore", I ndryshuar, Rregullores per Funksionimin e Keshillit te Bashkise, neni 54 germa "a", neni 42 dhe 43, Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates 28.08.2024, pasi diskutoi rreth kerkeses se Z.Mark Prenga dhe Z.Gjok Doda, banore te lagjes Gojan, fshat Kryezi, Njesia Administrative Qafe-Mali,

Vendosi:

Ngritjen e Komisionit te Perzier me perberje:

1.Bardhok Qafa	Anetar i Keshillit Bashkiak
2.Zef Cara	Anetar i Keshillit Bashkiak
3.Saimir Lleshi	Inspektor i Bordit te Kullimit, Ujitjes dhe Bujqesise
4.Nikolin Qafa	Pergjegjes i Policise Bashkiake
5.Ndrek Cuku	Kryetar i fshatit
6.Ndoc Mejdani	Anetar i Kryesise se fshatit per lagjen Gojan
7.Emanuel Mardodaj	Administrator i Njesise Qafe-Mali

Qellimi i ngritjes se Komisionit:

- Verifimi ne terren pas pretendimit te Z.Mark Prenga dhe Z.Gjok Doda.
- Marrja e informacionit nga rentaret e kesaj vije vaditese.

- Percktimi i menyres se zgjidhjes si dhe sjelljen prane zyres se Sekretariatit te Keshillit te dokumentacionit egzistues ne lidhje me kete problematike.

Kohezgjatja e punes se Komisionit:

-Deri ne zhvillimin e mbledhjes se Keshillit te muajit Shtator 2024.

Menyra e Funksionimit te Komisionit:

- Percaktohet nga Sekretari i Keshillit bashke me anetaret e keshillit ne Komision, daten e zhvillimit te takimit me Kryesine e fshatit dhe rentaret.
- Sjellja e dokumentacionit egzistues prane zyres se Sekretariatit.
- I propozon Keshillit vendimarrje, nese eshte ligjshme dhe e domosdoshme .
- Kerkon nga Kryesia e fshatit qe te shprehet me shkrim per problemin.

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Kryetari i Keshillit dhe Kryetari i Bashkise.

Ky vendim u miratua me 15 vota pro

Vota kunder 0 vota

Vota abstenim 0 vota

Ky vendim u shpall me date 04.09.2024.

SEKRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

